



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE

MINISTRI

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, - Tel: 2 270 630, Fax: 2 270 627 - www.moe.gov.al

Nr. ____ Prot.

Tirane, më ____ . ____ . 2012

U R D H Ë R

(Nr. ____ , datë ____)

PËR

GRUMBULLIMIN, MENAXHIMIN E MBETJEVE NE MJEDISET E MINSITRISE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË.

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 3 Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

U R D H Ë R O J:

1. Grumbullimin e diferencuar të letrës, plastikës dhe kanaçeve nga rrymat e tjera të mbetjeve që gjenerohen në mjediset e Ministrise si dhe ne institucionet tona të varësisë;
2. Në çdo kat apo mjedis të veçuar të ministrisë dhe të institucioneve të varësisë, duhet të ketë dy kosha mbeturinash me ngjyra të ndryshme dhe me etiketat përkatëse: koshi i bardhë për letrën dhe koshi blu për plastikën dhe kanaçen. Shishet plastike dhe kanaçet duhet të shtypen apo palosen për të reduktuar vëllimin e tyre në koshat përkatës. Detaje të hollësishme në lidhje me ndarjen e mbetjeve e sipas koshave përcaktohen në Aneksin 1 bashkëngjitur që është pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Personeli higjeno-sanitar duhet të marrë masa që të bëjë mbledhjen e veçuar të mbetjeve sipas koshave përkatës deri në largimin përfundimtar të tyre nga Ministria apo institucionet e varësisë. Në rast se personeli higjeno-sanitar duhet të shtypë apo palosë shishe plastike apo kanaçe të pashtypura apo të papalosura me qëllim për të reduktuar vëllimin në kosh.
4. Personeli higjeno - santiar duhet të marrë masa që koshat e jashtëm të mos tejmbushen duke lajmëruar menjëherë shoqërinë me të cilat bashkëpunon për të bërë grumbullimin në burim dhe

largimin e menjëhershëm të mbetjeve të gjenerura, si dhe largimin e mbetjeve të tjera sipas mënyrave të parashikuara.

5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet stafi i Ministrise dhe Institucioneve të varësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit me Publikun në Ministri si dhe strukturat e personelit në Insitucionet e varësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FATMIR MEDIU

DRAFT

ANEKSI 1

Koshi i bardhë - letra

Letra

- a. çfarë mund të hidhet në koshin e letrës: Letra të zakonshme zyre; Letra me ngjyra; Gazetë; Letra të printuara; Zarfa dhe ndarëse dokumentash (pasi ti keni hequr adezivin apo plastikën, nëse ka); Bizneskarta; Revista, broshura, fletëpalosje; Letra ambalazhi (pa përbërje plastike apo adeziv)
- b. çfarë nuk duhet hedhur në koshin e letrës: Mbetje organike (lëkura banana, apo produkte të tjera ushqimore pasi ndotin letrën e mbledhur; Letrat adeziv; Letrat transparent; ambalazhi i ushqimeve; letrat e wc-së; letrat e pastrimit; Gotat plastike; Hiri i cigareve; filma; Letra apo karton të ndotur me kimikate apo ushqim

Koshi Blu – plastika dhe kanaçet

Shishet e plastikës

Duhen zbrazur nga ajri apo lëngu që përmbanin, shtypini, mbyllini me kapak dhe i hidhni në koshin përkatës.

Alumini,

Kanoçe, letra alumini, mbulesa jogurtesh, objekte edhe kur janë të papastra, ato reciklohen ndaj mund ti hidhni në koshin përkatës.